

# Bashkimi Evropian për **Barazinë Gjinore** në Shqipëri - II

## Qëllimi i përgjithshëm

Zgjerimi i transpozimit të *acquis*<sup>1</sup> së BE-së për Barazinë Gjinore sjell rezultate pozitive në zhvillimin socio-ekonomik të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në Shqipëri.

## Objektivat kryesore të projektit

**Deri në vitin 2027, institucionet shqiptare të kenë zbatuar qeverisjen e përgjigjshme gjinore për të forcuar barazinë dhe mosdiskriminimin, për të promovuar fuqizimin e grave dhe të drejtat e njeriut në përputhje me *acquis* e BE-së për barazinë gjinore.**

Rezultatet do të përfshijnë:



Të paktën dy ligje dhe strategji të rishikuara në përputhje me *acquis*-në e BE-së për barazinë gjinore.



Të paktën 14 bashki<sup>2</sup> me një Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, të miratuar zyrtarisht, në përputhje me metodologjinë e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE), të vlefshëm për zbatim përtej vitit 2025.



Përmirësimi me 1.5 pikë në tërësi i Indeksit të Barazisë Gjinore. Rritja e përqindjes së dokumenteve të programimit IPA III që përfshijnë perspektivën gjinore.

## Partnerët Kryesorë

Kryeministria (KM); Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministre e Shtetit dhe Kryenegociatore; Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor; Zyra e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s; nëpunëset/nëpunësit e barazisë gjinore në ministritë e linjës dhe në nivel vendor; INSTAT; Delegacioni i BE-së; bashkitë e përzgjedhura.

### Kohëzgjatja e projektit

Nëntor  
2024

**36**

Muaj

Nëntor  
2027

### Buxheti i Projektit

**2,000,000**

Euro

### Donator



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

<sup>1</sup>Acquis për barazinë gjinore është një tërësi ligjesh, rregullash, rezolutash, deklaratash, rregulloresh, direktivash dhe traktatesh të BE-së që janë kërkesa kryesore për integrimin e Shqipërisë në BE.

<sup>2</sup>Lista paraprake e bashkive përfshin: Shkodër, Vau i Dejës, Tiranë, Durrës, Kavajë, Korçë, Lushnjë, Elbasan, Gramsh, Gjirokastrë, Kamzë, Pogradec, Përmet. Ato po vlerësohen në fazën fillestare.



## Produkti 1

Qeveria e Shqipërisë ka rritur kapacitetet për të **përafruar reformat, strategjitë, programet dhe planet sektoriale me acquis të BE-së për Barazinë Gjinore** dhe pasqyron vazhdimisht përgjigjshmërinë gjinore në përputhje me normat dhe **standardet globale për barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave**. Rezultatet e pritshme do të përfshijnë:

- Disponueshmërinë e të paktën 2 vlerësimeve me ndjeshmëri gjinore, diagnostikimin e mekanizmave të politikave dhe strukturave qeveritare.
- Të paktën 6 politika/ligje/strategji të rishikuara nga perspektiva e integritimit gjinor dhe barazisë gjinore në përputhje me acquis të BE-së për barazinë gjinore.
- Deri në 6 udhëzues për integrimin gjinor, të prodhuar për fusha të ndryshme politikash.
- Të paktën 60 persona me informacion dhe njohuri të shtuar për integrimin gjinor.
- Rrjetëzim dhe shkëmbime praktikash më të mira në vendet evropiane.

## Produkti 2

Bashkitë kanë **rritur kapacitetet për të zbatuar integrimin gjinor në politika dhe plane si dhe për të ndërmarrë veprime të përgjigjshme gjinore** në përputhje me kompetencat e tyre. Rezultatet e pritshme do të përfshijnë:

- Të paktën 4 dokumente, të hartuara nga Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore, me perspektiva gjinore të integruara.
- Të paktën 200 nëpunëse/nëpunës të nivelit bashkiak me kapacitete të rritura për përdorimin e mjeteve të integritimit gjinor.
- Të paktën 14 bashki me një Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) të kostuar dhe të miratuar, si dhe 9 raporte monitorimi për zbatimin e PVVBGJ, të përfunduara.
- Të paktën 1 dokument paraprak për kostimin e shërbimeve të përgjigjshme gjinore.
- Deri në 30,000 persona të mbuluar përmes aktiviteteve ndërgjegjëse për barazinë gjinore dhe anëtarësimin në BE.
- Mundësi për shkëmbim dhe rrjetëzim mbi qeverisjen e mirë vendore me bashkitë në zonën e Bashkimit Evropian dhe/ose në Ballkanin Perëndimor.

## Produkti 3

Qeveria qendrore dhe vendore ka **forcuar kapacitetet për të integruar perspektivat gjinore në prodhimin dhe përdorimin e të dhënave për të mbështetur politikat dhe veprimet**, për përparimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Rezultatet e pritshme do të përfshijnë:

- 90% e treguesve gjinorë për përpilimin e Indeksit të BE-së për Barazinë Gjinore, të disponueshëm.
- Pesë nisma të ndërmarra për mbledhjen e të dhënave lidhur me gjininë.
- Të paktën 200 përdoruese/përdorues dhe prodhuese/prodhues të dhënash të trajnuara/trajnuar për mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e tyre.
- Deri në 3 produkte njohurish për barazinë gjinore.
- Të paktën 3 burime të dhënash të menaxhuara nga qeveria qendrore dhe bashkitë.
- 5 raste përdorimi të statistikave gjinore, analizave dhe kërkimeve të disponueshme për të mbështetur hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve.
- 40 tregues gjinorë të rinj të vënë në dispozicion të publikut.

## Produkti 4

Qeveria e Shqipërisë ka **rritur kapacitetet për të zbatuar integrimin gjinor nëpërmjet programimit të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA)**. Rezultatet e pritshme do të përfshijnë:

- Elementet e integritimit gjinor në të paktën 4 dokumente programimi IPA/projekt për veprim.
- Të paktën 8 seminare dhe seanca këshillimi shtesë të ofruara për stafin e angazhuar në programimin e fondeve IPA të BE-së.
- Deri në 3 analiza gjinore specifike sektoriale në fushat prioritarë IPA III të BE-së.
- Deri në 3 fushata ndërgjegjëse të zhvilluara për standardet e BE-së në lidhje me barazinë gjinore.

## Përafrimi me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare

- Plani i Veprimit i BE-së për Barazinë Gjinore III (PVBGJ III) – 2021-2025 dhe vlerësimi i tij i ndërmjetëm.
- Plani i BE-së për zbatim në nivel kombëtar.
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030.
- Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026.
- Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 5 për Barazinë Gjinore, OZHQ 10 për Zvogëlimin e Pabarazive, OZHQ 16 për Paqen, Drejtësinë dhe Institucionet e Forta.
- Kuadri i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm (UNSDCF) 2022 – 2026, Rezultati 4 për Qeverisjen e Përgjigjshme Gjinore dhe Rezultati 2 për rritjen ekonomike të qëndrueshme, ripërtëritëse dhe të gjelbër, si dhe për menaxhimin e burimeve.
- Dokumenti Strategjik i UN Women 2022-2026.